
**THE ROLE OF THE ALBANIAN POLITICAL PARTIES IN THE CREATION OF THE
DEMOCRATIC INSTITUTIONS OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA - HISTORICAL AND
JURIDICAL VIEW**

Qashif Bakiu

qashif.bakiu@unite.edu.mk

Ylber Sela

Arsim Aziri

Abstract: In the scientific paper "The role of the Albanian political parties in the creation of the democratic institutions of the R.M- historical and juridical view" will be treated the role of the Albanian political parties in the first moment of the pluralist system of Macedonia. In this direction, is treated their role on the process of democratization of the state, integration in the political life, and also their impact in the definition of the form and the character of the state. In the paper are also treated concrete actions of the Albanian political parties, in the creation and foundation of the democratic institutions of the state. Special emphasis is given to the political decisions, for cases with juridical character, influenced by interethnic oppositions, which have negative impact in the democratization of the state. From this time perspective, in the paper are also given valuations on certain actions, which had positive or negative impact, in the political developments on the Republic of Macedonia.

Keywords: political parties, Albanian political factor, multi-ethnicity, political pluralism, democratic institutions

Një nga elementet më të rëndësishëm në historinë e ish – federatës së Jugosllavisë është se populli shqiptarë i Kosovës dhe Maqedonisë paraqesin bashkësinë etnike të parë, e cila ngriti pakënaqësinë e saj nga regjimi komunist shtetëror. Në mbështetje të kësaj janë faktet se federata jugosllave krijoi një sistem, i cili në çdo drejtim diskriminonte shqiptarët. Ky diskriminim është i dukshëm që nga themelimi i federatës së re, kur popullit shqiptar, i cili sipas numrit të përgjithshëm të popullsisë në Jugosllavi ishte i katërti për nga madhësia, mbetën pa republikë dhe nuk iu dha statusi i popullit. Ndërkaq tre popujve më të vegjël, sikurse janë sllovenët, maqedonasit dhe malazezët përfituan këtë të drejtë. Nëse këtë çështje e trajtojmë për nga parimi juridik se për krijimin e një shteti, përveç dëshirës së popullsisë, është e nevojshme edhe baza historike, atëherë argumentet sërish janë në anën e shqiptarëve. Në periudhën e Perandorisë Osmane Kosova ka statusin e vilajetit,⁵³² ndërsa në lashtësi ekziston si Dardani.⁵³³

VËSHTRIM HISTORIK DHE POLITIK

Pluralizmi politik në Republikën e Maqedonisë fillon si refleksion nga republikat federale të tjera të ish-federatës Jugosllave. Në këtë drejtim, duhet potencuar se Maqedonia radhitet ndër të fundit nga republikat e Jugosllavisë, e cila ndahet nga sistemi i vjetër një partiak, dhe atë pas Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe Kosovës⁵³⁴ e cila në këtë periudhë nuk kishte status të njëjtë me njësitë tjera federale.

Rrugën për pluralizmin politik në Maqedoni, por edhe më gjërë në Jugosllavi, juridikisht e hapin ndryshimet e Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), respektivisht amendamenti 59, me të cilin lejohet krijimi dhe themelimi i partive politike. Me një gjë të tillë, juridikisht i merret monopoli Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, respektivisht të Maqedonisë. Me këtë krijohet korniza ligjore e pluralizmit

⁵³² Vilajeti i Kosovës u krijua në vitin 1877 dhe përfshin gjithë territorin e sotshëm të Kosovës, në lindje shtrihet deri në Shtip, në perëndim deri në vilajetin e Shkodrës, ndërsa në veri kufizohej me Malin e Zi dhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Brenda kufijve të këtij vilajeti hynin edhe qyteti i Shkupit, Tetovës, Kumanovës, Shtipit, Radovishit, Koçanës, Kratovës; qytetet që aktualisht janë në territorin e Malit të Zi: Berane, Gucia, Tërgovishti; qytetet që aktualisht janë brenda kufijve të Serbisë: Novi Pazari, Senica, Kolashini, Novi Varosh, Prijepolje etj.

⁵³³ Dardania është emri i vjetër i Kosovës, që vjen nga emri i fisit ilir Dardanët. Shih. A. Stipçeviq, Ilirët, Prishtinë, 1990, fq. 38-44.

⁵³⁴ Duhet theksuar se partitë e para në Kosovë, të cilat paraqiten para shkatërrimit të federatës së Jugosllavisë, nuk funksionojnë në kuadër të sistemit (periudha e mosnjohjes së sistemit jugosllav – serb) dhe si të tilla veprojnë juridikisht si parti jolegale. Këto parti nuk janë regjistruar në organet shtetërore, organe të cilat kanë qenë të kontrolluara nga Serbia. Rrjedhimisht edhe zgjedhjet e ndryshme kanë qenë të organizuara nga organe paralele, jashta sistemit shtetëror serb – Jugosllavisë.

organizacional partiak. Edhe përkundër kësaj, Kushtetuta e vitit 1974 vazhdon të ruaj monopolin ideologjik komunist, e cila paraqitet si faktor bazë për mos zhvillimin e pluralizmit politik.

Pluralizmi politik paraqet vlerën themelore dhe kryesore të rregullimit kushtetues të Maqedonisë.⁵³⁵ Duke u nisur nga ky parim Kushtetuta e R. Maqedonisë garanton organizim të qytetarëve në parti dhe asociacione të tjera politike, me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes e të drejtave të tyre. Me Ligjin për partitë politike të vitit 2004, i cili reflekton parimet themelore të ligjeve të më hershmë për sa i takon organizimit politik, partitë politike paraqesin organizim vullnetar të qytetarëve, të formuara për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave politike, ekonomike, kulturore dhe të drejtave të tjera si dhe bindjeve, si edhe pjesmarrje në pushtet.⁵³⁶ Në këtë drejtim, kufizimi i vetëm është se veprimtaria, program dhe statuti i partisë politike nuk mund të jetë i orientuar drejt çënimit dhe shkatërrimit të rendit kushtetues, si dhe stimulimit të urrejtjes nacionale, racore dhe religjioze. Edhe përkundër kësaj, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe ligjet e saj, për dallim nga disa shtete të tjera në rajon nuk kufizojnë formimin e partive politike me prefikse nacionale apo edhe religjioze.

RROLI I SHQIPTARËVE NË KRIJIMIN E SHTETIT TË PAVARUR TË MAQEDONISË

Një etapë e re e pluralizmit politik në Republikën e Maqedonisë paraqitet me pavarësinë e shtetit dhe ndarjen nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë. Vetëm pas një viti jo të plotë nga zgjedhjet e para të lira dhe demokratike. Duke ndjekur trendin e republikave të tjera (Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës), më 8 shtator të vitit 1991, elitat politike në Shkup, vendosi që të realizohet një referendum për një shtet të pavarur dhe sovran.

Nw periudhën e parë të pluralizmit politik, faktori shqiptar në Maqedoni arriti të organizohet në mënyrë shumë të mirë. Menjëherë pas ndryshimeve kushtetuese me të cilat u lejua formimi i partive politike, shqiptarët e Maqedonisë u organizuan në parti politike – Partia për Prosperitet Demokratik, pas së cilës menjëherë regjistruan edhe partinë e dytë Partinë Demokratike Popullore. Me këtë shqiptarët e Maqedonisë arrin të mobilizojnë popullatën shqiptare në thuajse mbi 95 % në këto dy parti politike, duke anuluar në mënyrë shumë të shpejtë përkrahjen që kishte pasur deri në këtë moment Partia Komuniste e Maqedonisë.

Duke parë tendencën e përfaqësuesve politik maqedonas për krijimin e një shteti nacional, shqiptarët në Republikën e Maqedonisë krijuan partitë e tyre politike. Kjo tendencë ishte mjaft e shprehur gjatë procesit të ndërtimit të themeleve të shtetit të ri, e sidomos gjatë shpalljes së pavarësisë së shtetit si dhe gjatë hartimit të Kushtetutës. Duke e vërejtur këtë tendencë, të bazuar nga ajo se si rridhte procesi i pavarësimit të vendit, por edhe nga projekt kushtetuta e cila u ofrua nga një grup ekspertësh (në përbërje të pastër etnike maqedonase), partitë politike shqiptare – Partia për Prosperitet Demokratik dhe Partia Demokratike Popullore, shpallën bojkot të referendumit për pavarësi por edhe bojkot në miratimin e Kushtetutës së re. Edhe përkundër bojkotit nga ana e popullatës shqiptare, referendumi u realizua. U shpall pavarësia, pas së cilës fillon menjëherë përgatitja për Kushtetutën e re. Kushtetuta e re u pranua nga organi më i lartë i pushtetit legjislativ Kuvendi Republikan më 17 nëntor të vitit 1991.⁵³⁷ Duhet potencuar se edhe përkundër pjesëmarrjes në seancën Kuvendit, përfaqësuesit politik shqiptarë kanë bojkotuar miratimin e Kushtetutës së R. Maqedonisë, me mosvotim as pro, as kundër as abstenim.

VËSHTRIM JURIDIK

Miratimi i Kushtetutës së vitit 1991 paraqet një moment të ri për shtetin e ri të Maqedonisë. Aty edhe do të fillojnë problemet e shumta, të cilat pas 10 vitesh do të dëshmojnë si shumë tragjike. Kjo kushtetutë, nga shumë autorë konsiderohet si gjenerator i krizave ndëretnike në Republikën e Maqedonisë, sidomos për sa i përket krizës më të madhe – konfliktit të armatosur të vitit 2001. Presidenti i Republikës së Maqedonisë Kiro Gligorov, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, propozoi një komision ekspertësh katër anëtarësh, për përgatitjen e projekt kushtetutës.⁵³⁸ Në këtë komision hyjnë katër profesorët e njohur të Universitetit të Shkupit “Shën Kirili dhe Metodi”, Vllado Popovski, Lubomir D. Ferçkovski, L Lazar Kitanovski dhe Dimitar Mirçev. Në këtë përbërje, sikurse shihet nuk bën pjesë as edhe një shqiptar, ndërsa komisioni i njëjtë përgatiti kornizën kushtetuese të shtetit të ri të Maqedonisë. Ajo që do të vërehet pas hartimit të kornizës në fjalë është se, e njëjta në asnjë moment nuk do të kënaqë kërkesat e bashkësisë etnike shqiptare, e cila pretendonte për status të popullit shtetformues në shtetin e ri. Në të kundërt të

⁵³⁵ Kushtetuta e R. Maqedonisë viti 1991, Neni 8, alinea 4; Gazeta zyrtare; nr. 52, 1991

⁵³⁶ Ligji për partitë politike në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare; nr. 76; 2004

⁵³⁷ Vendimi për shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë; Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë; nr.52; 22. 09. 1991

⁵³⁸ Shih. K. Глигоров; Македонија е се што имаме; Shkup; 2002; fq. 213

kësaj, kjo kornizë kushtetuese dobësonte, pozicionin edhe ashtu të dobët të popullit shqiptarë, që kishte në ish federatën jugosllave. Kushtetuta paraqet aktin më të lartë normativ, akt i cili u paraprin të gjith akteve ligjore. Por, njëkohësisht paraqet edhe edhe aktin për themelimin e pushtetit, si dhe akt për konfirmin e marrëdhënieve themelore shoqërore. Në këtë rast, bashkësia e dytë etnike për nga madhësia, nuk mori garanca për realizimin e të drejtave të saj, nga baza juridike, mbi të cilën funksionon sistemi politik shoqëror. Në situatë kur një e treta e popullsisë ngelet jashta kornizës kushtetuese, është e pashmangshme pakënaqësia, e cila mund të reflektohet apo të shfaqet në mënyra të ndryshme në procesin e krijimit të shtetit.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991, është e ndërtuar nga nëntë pjesë, si dhe nga pjesa hyrëse – Preambula. Që nga pjesa hyrëse, shihet tendenca e qartë e shumicës maqedonase për krijimin e shtetit njënacional, e cila e mvesh mbi vete jo vetëm pjesën juridike dhe ekonomike, por edhe pjesën historike të krijimit të shtetit të Maqedonisë, si edhe në të kaluarën, kur ky koncept (term) politik nuk ka qenë i njohur. “Duke u nisur nga trashëgimia historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore e popullit maqedonas dhe luftës së tij për liri kombëtare dhe sociale dhe krijimin e shtetit të vet, e sidomos traditave shtetërore dhe juridike të Republikës së Krushevës dhe vendimeve historike të ASNOM-it dhe kontinuitetit juridik kushtetues të shtetit maqedonas si republikë sovraane në Federatën e Jugosllavisë, nga vullneti i lirë i qytetarëve në Republikën e Maqedonisë i shprehur në referendumin e 08 shtatorit të vitit 1991, si dhe nga fakti historik se Maqedonia është konstituuar si shtet kombëtar i maqedonasve, në të cilën u sigurohet barazi e plotë qytetare dhe bashkëjetesë e vazhdueshme të popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, romët dhe nacionalitetet e tjera të cilat jetojnë në Maqedoni...”.⁵³⁹ Prej këtu shihet qartë se humb karakteri qytetar i shtetit dhe se krijohen dy nivele (shtresa) të kolektiviteteve - bashkësi. Rrjedhimisht, Kushtetuta prodhon dy lloje të të drejtave kolektive, respektivisht të drejta për qytetarët e rendit të parë – popullit shtetformues dhe “të drejta” apo kufizime për qytetarët e tjerë të shtetit, të cilët nuk i takojnë bashkësisë etnike maqedonase në Republikën e Maqedonisë - qytetarë të rendit të dytë. Problemi bëhet edhe më i madh kur të kemi parasysh se njëra nga bashkësitë etnike që ngel në rendin e dytë, bashkësia shqiptare, sipas të dhënave zyrtare përbën më shumë se një të katërtën e numrit të përgjithshëm të popullsisë që jeton në Republikën e Maqedonisë.⁵⁴⁰ Ndërkaq, e drejta historike mbështetet në faktin se shqiptarët si pasardhës të ilirëve, janë popullsi autoktone në territoret e Maqedonisë së sotme.⁵⁴¹ Ndërkaq, një mbështetje më e fortë e kësaj teze është edhe fakti i argumentuar nga shumë historian botëror se termi Maqedoni, si term politik dhe juridik nuk është prezent deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Përfundimisht bëjnë momente të caktuara gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, kur grupe të veçanta përmendin emrin Maqedoni, pa e përcaktuar tërësinë territoriale të cilën e përfshin. Karakteristike për geto grupe të armatosura është se ata veprojnë në territore të cilat sot i takojnë Republikës së Bullgarisë, në veri të Greqisë, si dhe në disa pjesë të Maqedonisë lindore të sotshme. Për këto grupe, historianët bullgarë pretendojnë se kauzë të tyre kanë pasur shtetin bullgar. Argumente të tjera në përkrahje të së drejtës historike të bashkësisë etnike shqiptare janë edhe faktet se popullata shqiptare ka marrë pjesë aktive për çlirimin e këtyre territoreve si nga Perandoria Osmane, poashtu edhe nga fashizmi.

Rregullimi Kushtetues i Republikës së Maqedonisë përjeton ndryshime rrënjësore pas konfliktit të armatosur të vitit 2001. Si rezultat i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.⁵⁴² U realizuan ndryshime të mëdha në Kushtetutë, me çfarë u ndryshua edhe karakteri njënacional i shtetit. Me kushtetutën e re, edhe oficialisht, Republika e Maqedonisë u bë shtet multietnik, në të cilën pranohen edhe bashkësitë e tjera etnike, rrjedhimisht edhe bashkësitë etnike shqiptare, turke, vllahe, rome, boshnjake dhe serbe, të cilët jetojnë në këtë shtet. Me ndryshimet në fjalë, Republika e Maqedonisë, me Kushtetutë, përcaktohet për mbrojtjen e të drejtave të bashkësi etnike. Kjo shprehet që në fillim të tekstit të ndryshuar të Preambullës së Kushtetutës ku theksohet “Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, popullit maqedonas, si dhe qytetarët të cilët jetojnë brenda kufijve të saj të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak e të tjerë, duke e marrë përsipër përgjegjësinë për të tashmen dhe të ardhmen e atdheut të tyre, të vetëdijshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve të tyre për viktimat dhe përkushtimin e përpjekjeve të tyre dhe luftës për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Maqedonisë, dhe përgjegjës para gjeneratave të ardhshme për ruajtjen dhe zhvillimin e të gjithë asaj që është e vlefshme nga trashëgimia e pasur kulturore dhe bashkëjetesa në Maqedoni, të barabartë në të drejtat dhe obligimet e tyre për të

⁵³⁹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë; Preambula; Gazeta Zyrtare e R.M.; Nr. 52, 1991.

⁵⁴⁰ Shih. Z. Rexhepi, ; Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarëve në Maqedoni 1990 – 2001; fq. 47-48.

⁵⁴¹ Shih. A. Stipčević, Ilirët, Prishtinë 1990, fq. 39-40.

⁵⁴² Me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, të nënshkruar më 13 gusht të vitit 2001 nga ana e katër liderëve të partive më të mëdha maqedone dhe shqiptare, me garanci nga komuniteti ndërkombëtar (SHBA dhe BE), u ndërpre konflikti i armatosur gjatë mujor ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe forcave të Republikës së Maqedonisë.

mirën e përbashkët – Republikës së Maqedonisë - në përputhje me traditën e Republikës së Krushevës dhe vendimet e KAÇKM-së dhe të Referendimit të 8 shtatorit të vitit 1991, vendosën ta konstitujnë Republikën e Maqedonisë si shtet të pavarur, sovran, me qëllim që të vendoset dhe forcohet sundimi i së drejtës, që të garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë qytetare, të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës individuale dhe të përbashkët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të zgjedhur në zgjedhjet e lira dhe demokratike”⁵⁴³.

Ndërkaq në anën tjetër me Kushtetutën e e vitit 2001, R. Maqedonisë paraqet “shtet nacional të popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë...”⁵⁴⁴

Sikurse dihet, popullsia e Maqedonisë në vete ngërthen dy grupe etnike të mëdha, pesë pakica etnike më të vogla, si dhe disa grupe të tjera etnike të cilat nuk kanë përqindje relevante në përbërjen e popullsisë. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2001, njihen të gjitha bashkësitë etnike. Kështu që me këto ndryshime Republika e Maqedonisë paraqet një shtet shumë nacional. Problemi qëndron se si ky status kushtetues i bashkësive etnike të marr refleksionin përkatës në sistemin qeverisës, në sistemin politik; cila është forma më e mirë e demokracisë, e cila do të garantojë plotësisht të drejtat dhe liritë e bashkësive etnike joshumicë.

PËRFUNDIM

Partitë politike në spektrin politik në Maqedoni mbi të gjitha dhe realisht janë etnike, dhe shumë pakë nominalisht dhe në formë fiktive ato janë ideologjike. Dy partitë kryesore të maqedonasve kanë një ideologji bazike: në mënyrë shumë të kujdesshme kultivojnë maqedonizmin. LSDM-ja përfundimisht në mënyrë sistemore, me anë të personalitetit dhe institucionalisht, shpesh në mënyrë të qetë, të fshehtë port ë sigurt. VMRO-DPMNE-ja zhurmshëm, luftarakisht dhe frenetikiisht, dukshëm dhe në mënyrë sfidonte kultivon maqedonizmin. Dallimi ndërmjet partive shqiptare BDI dhe PDSH, por edhe partitë e reja si Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja Besa, edhe përkundër deklarimeve për orientim ideologjik të majtë dhe të djathtë, janë vetëm mjet dhe rezultatet të arritura në luftën për të avancuar pozitën e shqiptarëve në Maqedoni.

Roli i partive shqiptare në krijimin e shtetit të pavarur, por edhe të organeve dhe institucioneve në Republikën e Maqedonisë është mjaft aktiv. Parë nga kjo perspektivë, në plan historik ky aktivitet do të mund të periodizohej dhe sistemohej në tre segmente:

1. Roli i faktorit politik shqiptarë në periudhën e pavarësimit të shtetit dhe njohjen ndërkombëtare,
2. Roli i faktorit politik shqiptarë në ndaljen e konfliktit të armatosur të vitit 2001
3. Roli i faktorit politik shqiptarë në integrimin e vendit në NATO dhe Bashkimin Evropian

Në vijë të konstatimit se faktori politik shqiptarë ka qenë mjaft aktiv, mund ti shtohet edhe elementi bashkëpunues, i cili signifkohet vazhdimisht ndërsa karakterizohet në momentet më të rëndësishme të historisë së shkurtër të Maqedonisë. Duhet potencuar se në momentet më të rëndësishme faktori politik shqiptarë ka qenë në vijë të ruajtjes së interesit shtetëror, duke mos shprehur asnjëherë tendenca për shpëputje nga shteti, respektivisht nuk e ka çenuar asnjëherë tërësinë territoriale shtetërore. Kjo gjë vjen në shprehje në periudhën e pavarësimit të shtetit, ku faktori politik dhe eksponentë të saj ishin të parët që kërkuan pavarësinë e Maqedonisë nga shteti federativ i Jugosllavisë. Në vijë të njëjtë ky faktor është edhe në periudhën e konfliktit të armatosur të vitit 2001, ku partitë politike kryesore shqiptare të kohës, PPD dhe PDSH, morën pjesë aktive në bisedimet për ndërprerjen e konfliktit dhe arritjen e një marrëveshje politike – Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Gjithashtu ky rrol aktiv do të jetë prezent edhe në implementimin e kësaj marrëveshje. Gjithashtu duhet potencuar se faktori politik shqiptar në Maqedoni, jo vetëm deklarativisht, por edhe praktikisht është ndër faktorët politik më aktiv për integrimin e Maqedonisë në NATO dhe Bashkimin Evropian. Kjo gjë mund të vërehet si në procesin e zbatimit dhe implementimit të kërkesave të cilat janë kusht për tu integruar, poashtu edhe në aktivitet që ky faktor po shënon në skenën ndërkombëtare. Duhet potencuar se në periudhën 27 vjeçare të ekzistimit të shtetit të Maqedonisë, janë disa momente kur faktori politik maqedonas ka lëvizur nga këto vija strategjike, ndërsa për dallim, faktori politik shqiptar ka pasur politikë konzistente, duke mos u larguar asnjëherë nga agjenda euroatlantike.

LITERATURA

- [1] A.Stipçeviq, Ilirët, Prishtinë 1990, fq. 39-40.

⁵⁴³ Amandamenti IV i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë; Gazeta Zyrtare e R. M.; Nr. 91, nga 20. 11. 2001 r.

⁵⁴⁴ Preambulla; Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë; Preambulla; Gazeta Zyrtare e R.M.; Nr. 52, 1991..

- [2] Д. Милър, Д. Колман, У. Конали, А. Райън. Енциклопедия Блекуел на политическата мисъл. С. 1997,
- [3] К. Frasheri, E verteta mbi shqipetaret e Maqedonise dhe shtrebbimet e Enciklopedise se Shkupit; Maqedonia Shqiptare I; 2009; Tetove
- [4] К. Глигоров; Македонија е се што имаме; Shkup; 2002;
- [5] Л. Дачев, Учение за државата. Софија; 2001
- [6] М. Glenny, Historia e Ballkanit 1804 -1999. Nacionalizmi, Lufterat dhe Fuqite e Medha, (The Balkans, 1804-1999, Nationalism, ëar and the great poëers), Tirana, 2007
- [7] Qashif Bakiu, Pluralizmi politik në Republikën e Maqedonisë, Sofje, 2012
- [8] С. Шкарик, Г. Силяновска-Давкова, Уставно Право; второ издание, Скопје, 2009
- [9] С. Климовски, Уставен и политички систем, Скопје, 1997,
- [10] Ulf Brunnbauer; Mitet historike ne historiografinë maqedonase; Maqedonia Shqiptare I; 2009; Tetove
- [11] Kushtetuta e R. Maqedonisë viti 1991, Neni 8, alinea 4; Gazeta zyrtare; nr. 52, 1991
- [12] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë; Preambula; Gazeta Zyrtare e R.M.; Nr. 52, 1991
- [13] Ligji për partitë politike në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare; nr. 76; 2004
- [14] Vendimi për shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë; Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë; nr.52; 22. 09. 1991
- [15] Amandamenti IV i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë; Gazeta Zyrtare e R. M.; Nr. 91, nga 20. 11. 2001